



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 102/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundrejt Sabri Berisha dhe Lavdim Isufi për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN

Arsyetim

Me datën 24.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë BIRN, me të cilën pretendohet se me datën 23.01.2011 në QV 1112b VV 1112b/02r në shkollën fillore "Fivzi Sylejmani" në fshatin Kqiq i Madh të komunës së Mitrovicës u mbyll procesi i votimit dhe filloj numërimi i votave të partive politike.

Sipas parashtruesit të ankesës gjithçka shkoi mire deri në momentin kur filloi numërimi i votave të kandidatëve të PDK-së, me ç'rast janë vjedhur votat e disa kandidatëve dhe si rrjedhojë janë shtrembëruar rezultatet nga ana e dy komisionarëve që i shënonin votat në fletën llogariste për votat e kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës ai i PDK-së Sabri Berisha dhe komisionari i FER-it Lavdim Isufi.

Sipas parashtruesit të ankesës dy të lartpërmendurit kanë vjedhur votat për kandidat të caktuar duke mos i shënuar siç duhet rezultatet e kandidatëve në fletën llogariste për votat e kandidatëve, ashtu siç kanë votuar qytetaret dhe siç ua lexonte komisionari tjetër, dhe të cilat janë pare nga afër nga vëzhguesi i BIRN-it. Në vend të kësaj, Berisha dhe Gashi në fletën llogariste u kanë shënuar vota, kandidatëve të tyre të

preferuar, pavarësisht se ata nuk kane qene te votuar nga qytetaret. Votat u janë e vjedhur kandidateve me numër: 24,86 dhe 53 ndërsa u janë shtuar kandidateve me numër: 20,25,73,68 dhe 69. Berisha dhe Isufi, po ashtu nuk i numëronin për te dytën here votat e kandidateve ne shtyllën prej 25 votash ne fletën llogaritëse, ku rezultatet nuk përputheshin, siç do te duhej ku nuk përputhej rezultati nga komisionari i pare, e lexon i dyti e kështu me radhe. Kur mbaroi numërimi, rezultatet ne fletën llogaritëse për votat e kandidateve te të dy komisionarëve, Sabri Berisha dhe Lavdim Isufi nuk u përputhen dhe kështu për tu harmonizuar rezultatet, këta komisionar hiqnin ose u shtonin vota kandidateve te caktuar, vetëm qe rezultati te përputhet.

Sipas BIRN, vjedhja e votave te kandidateve apo shtrembërimi i rezultateve te kandidateve paraqet shkelje te nenit 182 te KPK -së , mashtrimi ne Votime. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me numërimin e votave te kandidateve te LDK-së ku kryesuesi nga AKR-ja Asllan Beka i ka lexuar numrat kur vëzhguesi i PDK-së i cili me rregulla nuk lejohet te shënoj rezultatet, u ka shënuar votat ne fletën llogaritëse te rezultateve kandidateve qe ka dashur, gjë kjo qe ka nxjerr reagimin e kryesuesit. Per me teper, vëzhguesi nuk lejohet qe te numëroj dhe te shënoj rezultatet ne fletën llogaritëse te rezultateve te kandidateve. Po ashtu ne këtë vendvotim, ne te njëjtën kohe është bere numërimi i rezultateve te votave te kandidateve i dy partive politike, PDK dhe LDK dhe ne tavolina ndërse, çka ka bërë te pamundur qe vëzhguesit te jen te pranishëm në dy tavolinat e numërimit në te njëjtën kohë. Në Qendrën e votimit 1112b, te drejtë vote kanë pasur 3102 qytetar, kanë votuar 1177 sosh. Fletëvotime te vlefshme : 1058. Të pavlefshme: 79. Për 40 fletëvotime te tjera, menaxheri i Qendres së Votimit , Ferik Beka nuk ka dhënë informacion.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:
- **ankesa është e pabazuar.**

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP i beri një kërkesë për material zgjedhor në KQZ-QNR me datë 25.01.2011 për konfirmim, që ti siguroj tere materialin zgjedhor per VV-ne perkatese si dhe me date 26.01.2011 nje kerekese per Raportin e Auditimit dhe Rinumerimit per te njëjten VV.

PZAP shqyrtoi materialin zgjedhor si dhe Raportin e Auditimit dhe Rinumerimit per VV 1112b/02R dhe erdhi në përfundim se parregullsite e pretenduara jane eliminuar gjate rinumerimit dhe auditimit nga KQZ-ja. Si rrjedhim PZAP konstatoj se pretendimet e parashtruesit te ankeses jane korrigjuar dhe pere kete arsye e refuzoi ankesen si te pabazuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 102/2011 më datën 26.01.2011.

